



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1502/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.N.P “Dy Vëllezërit Sahiti ” me numër unik identifikues 810560434 me seli ne Vushtrri ndërtesa MBC, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gjejlan Pasoma avokate me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhoma e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1639/22 datës 20.09.2023, me datë 06.06.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit Komuna e Mitrovicës, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1639/22 i datës 20.09.2023 dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

#### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1639/22 dt.20.09.2023, e ka refuzuar si të papabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës, ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.1577/21 dt.17.12.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë debitori përmes përfaqësueses së autorizuar, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj si te bazuar këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështja te kthehet ne shkalle te parë ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.N.P “Dy Vëllezërit Sahiti” me numër unik identifikues 810560434 me seli ne Vushtrri ndërtesa MBC, më datën 17.12.2021, ka paraqitur propozim për përmbaram ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.17/20 dt.10.09.2020, nr.02 dt.09.08.2021 dhe nr.01 dt.06.05.2021. Përmbaruesi privat Atip Mustafa, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.1577/21 dt.17.12.2021, ka lejuar përmbaramin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat t’i paguaj shumën prej 19,779.05 euro, me kamatëvonesë ligjore prej 8 % ne vit si dhe shpenzimet përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 18.02.2022, me te cilin pretendon se urdhri përmbarimor i lejuar nga përmbaruesi privat është joligjor dhe i parregullt, faturat nuk janë juridikisht te vlefshme dhe te përshtatshme për përmbaram, në to nuk janë cekur te dhënat e nevojshme për debitorin dhe ne to nuk përcaktohet me saktësi detyrimi sipas objektit, llojit, vëllimit, dhe kohës se përmbushjes se tij. Po ashtu propozimi për përmbaram nuk i përmban te gjitha kushtet e kërkuara ligjore nga neni 38 par.1 te LPP-së sepse nuk është përcaktuar adresa e vendbanimit te debitorit. Në seancën dëgjimore përfaqësuesi i autorizuar i debitorit kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor sepse faturat nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm, nuk përmbajnë vulën e protokollit të debitorit, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor te shfuqizoj.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit ne seancën dëgjimore kundërshton deklarimet e debitorit si kundërtënës ngase kreditori me debitorin kane marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar me datën 01.04.2020 ndërsa borxhi është krijuar në bazë të njëjtës marrëveshje. Faturat janë pranuar nga zyrtarja e debitorit V.R., e cila i ka pranuar të gjitha faturat ne Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastruktura pranë Komunës së Mitrovicës së Jugut

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të provave, dhe pretendimeve te palëve në seancën dëgjimore ka marrë vendim me te cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. E njëjta gjykatë ne vendimin e saj ka arsyetuar se urdhri përmbarimor bazohet ne dokumente te besueshme përkatësisht faturat mbi te cilat është lejuar përmbarami kanë tiparet e dokumentit te besueshëm, janë te përcaktuara te dhënat e kërkuara me dispozita ligjore përkatësisht nenit 29 par.3 te LPP , dhe se të njëjtat burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit për nen kontraktimin e shërbimeve, e lidhur mes debitorit dhe kreditorit. Gjykata vlerëson se faturat i plotësojnë te gjitha kushtet nga neni 37 i LPP pasi janë e dorëzuar ne origjinal. Gjykata ka analizuar pretendimet e debitorit se faturat ne fjale nuk mbajnë vulën e pranimit te debitori dhe te dhënat e nevojshme te debitorit mirëpo këto pretendime gjykata i vlerësoi si te pabazuara sepse debitori nuk ka sjell asnjë provë se personi qe i ka pranuar këto fatura dhe i ka nënshkruar me emër dhe mbiemër nuk është zyrtar apo person i autorizuar për pranimin faturave dhe se nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori se bashku me propozimin për përmbaram ka ushtruar edhe deklaratë për arritshmërinë e kërkesës konform nenit 30 te LPP, nga këto arsye kjo gjykata kaq vendos si ne dispozitiv te aktvendimit te saj.

Gjykata Komerciale -Dhomat e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 29 paragrafi par.3 të LPP-së.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nuk ka analizuar saktë shkresat e lëndës si dhe nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike përkitazi çështjes se faturat në bazë të cilave është lejuar përbarimi, a i plotësojnë kushtet ligjore për tu konsideruar si dokumente të besueshme dhe se të njëjtat a përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen me dispozitat ligjore nga neni 29 par.3 të LPP. Nga shkresat e lëndës shihet qartë se në rastin konkret faturat në fakt janë të nënshkruara nga një person V.R., dhe vetëm fatura nr.01 dt.06.05.2021 është e protokolluar nga debitori, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimit të një dokumenti nga organi përkatës i një institucioni, ndërsa një mungesë e tillë e evidentimit në regjistrat e protokollit të organit përkatës të debitorit sjell në kontestim subjektivitetin e kreditorit si subjekt me të drejtë të arkëtimit të asaj shume në procedurë përbarimore. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se fakti se debitori si institucion publik pranon dokumente, përfshirë në rastin konkret faturat kontestuese të pa protokoluara, të nënshkruara nga personi V.R., nuk nënkupton se ka pranuar faturat dhe detyrimin nga këto fatura, pra nënshkrimi i dokumenteve nga cilido zyrtari, pa u pranuar në mënyrën e rregullt sipas procedurave të brendshme të institucionit nuk e bën valide faturën. Që faturat të konsiderohen se janë pranuar me rregull, do të duhej që debitori si palë kontraktuese, të pranonte faturat me rregull përmes protokollimit në regjistrat përkatës nga organi përgjegjës apo i autorizuar, shtu këtu edhe faktin se vetëm njëra faturë e datës 06.05.2021 është e protokolluar nga debitori, ndërsa fatura nr.17/2020 dt.10.09.2020 nuk përmban vule të protokollit dhe e njëjta nuk ka numër reference të Kontratës Publike Kornize të lidhur me palëve MI 642-20-672-5-2-5, dhe fatura nr.02 datës 09.08.2021 nuk përmban vule protokollit nga debitori.

Andaj bazuar në këto arsye kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivlerësim.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh të gjeturat e gjykatës së shkallës së dytë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi, nëse faturat nr.17/20 dt.10.09.2020 dhe nr.02 dt.09.08.2021, sipas dispozitave të LPP-së, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, të marrë parasysh pretendimet e palëve në procedurë, e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1502/23 me datë 06.06.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha